



Të dashur kolegë, partnerë dhe studentë,

Me kënaqësi të veçantë ju prezantojmë edicionin e parë të Newsletter-it të Zyrës për Marrëdhënie Ndërkombëtare të Kolegjit AAB, një hap i ri në drejtim të transparencës, përfshirjes dhe ndarjes së sukseseve tona me komunitetin tonë të gjerë brenda dhe jashtë vendit. Duke reflektuar mbi misionin tonë për të krijuar ura bashkëpunimi dhe për të mundësuar përvojë transformuese ndërkombëtare, ky newsletter synon të sjellë më afër historitë, iniciativat dhe mundësitë që po formësojnë dimensionin global të AAB-së. Si Prorektore për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Bashkëpunim besoj se ndërkombëtarizimi nuk është thjesht një opsion, por një domosdoshmëri për arsim cilësor dhe të qëndrueshëm. Kjo platformë do të shërbejë si dritare për të ndarë rrugëtimin tonë të përbashkët drejt një institucioni gjithnjë e më të hapur, më bashkëpunues dhe më të pranishëm në hartën akademike ndërkombëtare.

Mirë se na bashkoheni në këtë udhëtim!

AKTIVITETE NGA **JAVA** NDËRKOMBËTARE E STAFIT



Kolegji AAB hap zyrtarisht Javën Ndërkombëtare të Stafit

Kolegji AAB ka hapur zyrtarisht Javën Ndërkombëtare të Stafit, një ngjarje me karakter akademik që mbledh përfaqësues nga institucione të arsimit të lartë evropian. Ceremonia solemne u hap nga Prorektoria për Marrëdhënie Ndërkombëtare, znj. Venera Lljunji, dhe Rektori Prof. Dr. Blerim Olluri, të cilët theksuan rëndësinë e ndërkombëtarizimit dhe përvojave akademike ndërkulturore. Delegacionet pjesëmarrëse ndanë praktikatat më të mira nga institucionet e tyre, përfshirë universitete nga Norvegjia, Turqia, Lituania, Çekia dhe Hungaria. Java do të karakterizohet nga seminare tematike, prezantime shkencore dhe vizita kulturore, duke krijuar mundësi për shkëmbim dhe bashkëpunim të ndërsjellë. Kjo iniciativë e konsolidon rolin e AAB-së si pjesë aktive e hapësirës evropiane të arsimit të lartë dhe si platformë për ndërtimin e partneriteteve të reja akademike.



Java Ndërkombëtare e Stafit **Organizohet tryezë dhe punëtori për institucionet e arsimit të lartë**

Gjatë ditës së tretë të Javës Ndërkombëtare në AAB, u mbajtën një tryezë dhe një punëtori që theksuan rëndësinë e ndërkombëtarizimit dhe qëndrueshmërisë në arsimin e lartë. U diskutua për ndërtimin e partneriteteve ndërkombëtare, shkëmbimet akademike dhe përdorimin e teknologjisë digjitale për të zgjeruar mundësitë globale. Punëtorja e udhëhequr nga Ilirjana Geci dhe Erëza Mehmeti u fokusua në ndërtimin e institucioneve të qëndrueshme përmes menaxhimit të burimeve dhe përgjegjësisë shoqërore.



Pjesëmarrësit e Javës Ndërkombëtare të Stafit pjesë e udhëtimit nëpër Kosovë

Në kuadër të Javës Ndërkombëtare të Stafit, profesorët ndërkombëtarë vizituan disa nga vendet më domethënëse kulturore e historike të Kosovës, duke përjetuar një udhëtim ndërkulturore dhe reflektues. Ata vizituan Prekazin, ku u njohën me historinë e familjes Jashari dhe rezistencën kombëtare. Në Radavc, përjetuan bukuritë natyrore dhe shpellën “Bukuroshja e Fjetur”, ndërsa në Prizren u njohën me trashëgiminë multikulturore e ndërfetare përmes monumenteve si Lidhja e Prizrenit dhe objektet fetare. Ky udhëtim i dha thellësi shkëmbimeve akademike përmes përjetimit të vlerave lokale.



Universiteti Teknik i Konya-s dhe **Kolegji AAB** rikonfirmojnë partneritetin në Javën Ndërkombëtare të Stafit

Në kuadër të Javës Ndërkombëtare të Stafit, Rektori i AAB-së Prof. Dr. Blerim Olluri dhe Prorektorja për Marrëdhënie Ndërkombëtare Prof. Asoc. Dr. Venera Lljunji pritën përfaqësues të Universitetit Teknik të Konya-s për të rikonfirmuar partneritetin mes dy institucioneve. Takimi shërbeu për të diskutuar shkëmbime përmes programit Erasmus+, projekte të përbashkëta kërkimore dhe aktivitete akademike ndërkombëtare. Mysafirët turq morën pjesë aktive edhe në sesionet e Javës Ndërkombëtare, duke ndarë përvoja dhe theksuar rëndësinë e bashkëpunimit global në arsim.



Dekani i Fakultetit të Komunikimit Masiv zhvillon takime me profesorët pjesëmarrës në Javën Ndërkombëtare të Stafit

Në kuadër të Javës Ndërkombëtare të Stafit, Rektori i AAB-së Prof. Dr. Blerim Olluri dhe Prorektorja për Marrëdhënie Ndërkombëtare Prof. Asoc. Dr. Venera Lljunji pritën përfaqësues të Universitetit Teknik të Konya-s për të rikonfirmuar partneritetin mes dy institucioneve. Takimi shërbeu për të diskutuar shkëmbime përmes programit Erasmus+, projekte të përbashkëta kërkimore dhe aktivitete akademike ndërkombëtare. Mysafirët turq morën pjesë aktive edhe në sesionet e Javës Ndërkombëtare, duke ndarë përvoja dhe theksuar rëndësinë e bashkëpunimit global në arsim. Ai diskutoi me p



rofesoreshën Solveig Omland nga NLA University College në Norvegji për mundësinë që studentët e AAB-së të ndjekin një semestër studimi atje, duke u hapur rrugë bashkëpunimeve konkrete që nisin që nga semestri vjeshtor. Takim tjetër u mbajt me prof. Enbiya Özkan nga Universiteti Balikesir, Turqi, në funksion të zgjerimit të partneriteteve akademike.

Profesoreshat nga NLA University në Norvegji mbajnë ligjëratë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja

Studentët e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Kolegjin AAB ndoqën një ligjëratë interaktive nga profesoreshat norvegjeze Solveig Omland dhe Katrine Mellingen Bjerke, mbi diversitetin kulturor dhe përfshirjen e komuniteteve etnike në Norvegji. Përmes një filmi të shkurtër dhe diskutimit të hapur, studentët u njohën me sfidat e integritit të emigrantëve në shoqërinë norvegjeze dhe rëndësinë e ndërtimit të një mjedisi gjithëpërfshirës. Diskutimi nxitës përfshiu perspektiva të ndryshme mbi mirëkuptimin kulturor në një kontekst global.



Profesori nga Newton University mban ligjëratë në Fakultetin Juridik të Kolegjit AAB

Në kuadër të Javës Ndërkombëtare të Stafit, Fakulteti Juridik i Kolegjit AAB mirëpriti Prof. Robert Westbrook nga Newton University në Republikën e Çekisë, i cili mbajti ligjëratat për studentët dhe stafin akademik të këtij fakulteti. Ligjëratat e tij trajtuan tema të rëndësishme të të drejtës ndërkombëtare dhe qasjet krahasuese në edukimin juridik, duke sjellë një perspektivë të gjerë evropiane dhe përvoja praktike nga një sistem tjetër arsimor. Gjatë vizitës, profesori Westbrook ndau përvojat e tij rreth organizimit të programeve studimore, sfidave të globalizimit në arsimin juridik dhe praktikave të angazhimit të studentëve në aktivitete akademike ndërkombëtare.



Dekani i Fakultetit të Kulturës Fizike mirëpret në takim profesorët nga Universiteti i Caen në Francë

Në kuadër të Javës Ndërkombëtare të Stafit, dekani i Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit në Kolegjin AAB, Prof. Fatmir Pireva, zhvilloi takime me profesorët Olivier Thenaisy, Sandra Perez Ramos dhe Guillaume Hernandez nga Universiteti i Caen në Francë. Një pikë e rëndësishme e diskutimit ishte përforcimi i partneritetit trepalësh mes Fakultetit të AAB-së, Universitetit të Caen dhe organizatës franceze "Play International", me të cilën tashmë ka një bashkëpunim të suksesshëm.



Mbylli punimet konferenca shkencore ndërkombëtare me pjesëmarrës nga 21 vende të botës

Konferenca shkencore ndërkombëtare e organizuar nga Kolegji AAB u moderua nga prorektorja Venera Lljunji, e cila theksoi rëndësinë e mbajtjes së aktiviteteve që promovojnë përshtatjen me zhvillimet teknologjike globale. Rektori Blerim Olluri përmendi synimin e konferencës për të krijuar një platformë bashkëpunimi ndërkombëtar. Folësi kryesor, Jürgen Rudolph nga Akademia Kaplan në Singapor, analizoi ndikimin shumëdimensional të inteligjencës artificiale në fusha si media, biznes, shëndetësi dhe kulturë.



Përmyllet suksesshëm Java Ndërkombëtare e Stafit në Kolegjin AAB

Java Ndërkombëtare e Stafit në Kolegjin AAB u përmyll me sukses përmes një ceremonie që shënoi kulmin e një jave të pasur me bashkëpunim akademik, shkëmbim kulturor dhe rrjetëzim ndërinstitucional. Prorektorja Venera Lljunji falënderoi pjesëmarrësit dhe theksoi vlerën e përvojave të përbashkëta që tejkalojnë kufijtë. Rektori Blerim Olluri vlerësoi kontributin e mysafirëve ndërkombëtarë dhe ripotencoi përkushtimin e AAB-së ndaj partneriteve globale. Në fund, të ftuarve iu ndanë certifikata si shenjë mirënjohjeje.



VIZITA NGA DELEGACIONE NDËRKOMBËTARE DHE AMBASADA

Delegacioni nga Universiteti Gazi në Ankara zhvillon vizitë dhe takime në Kolegjin AAB



Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, Kolegji AAB mirëpriti delegacionin nga Universiteti Gazi në Ankara, të kryesuar nga rektori Uğur Ünal. Takimi u fokusua në mundësitë e bashkëpunimit përmes programit ERASMUS+, me theks në shkëmbimet akademike, projekte të përbashkëta dhe bashkëpunim në fushat e Infermierisë, Radiologjisë dhe Stomatologjisë. Palët pritet të nënshkruajnë një Marrëveshje Mirëkuptimi që do të hapë rrugën për projekte të reja institucionale.



Delegacioni nga Nigeria në vizitë zyrtare në Kolegjin AAB – Në fokus thellimi i bashkëpunimit akademik dhe ndërkombëtar

Kolegji AAB mirëpriti një delegacion akademik nga Nigeria, përbërë nga pesë profesorë të fushave të ndryshme si Shkencat Kompjuterike, Edukimi, Menaxhmenti dhe Gjuha Angleze. Delegacioni u prit nga Rektori Blerim Olluri, Zëvendësrektori për Zhvillim Strategjik Ilir Bytyçi dhe Prorektorja Venera Lljuni, ku u diskutuan mundësitë për bashkëpunim ndërinstitucional në fusha akademike, shkëmbim stafi dhe studentësh, si dhe përfshirja në projekte kërkimore dhe konferenca ndërkombëtare. Gjatë vizitës, delegacioni zhvilloi takime edhe me dekanët e fakulteteve përkatëse dhe Drejtoreshën e Zhvillimit të Projekteve, duke thelluar kështu marrëdhëniet dhe bashkëpunimin institucional.



Ambasadorja e Izraelit viziton Kolegjin AAB për promovimin e librit “Dita kur çdo gjë ndryshoi”

Kolegji AAB mirëpriti ambasadoren e Izraelit në Kosovë, Sh.S. Tamara Ziv, në kuadër të promovimit të librit të ilustruar “Dita kur çdo gjë ndryshoi”, botuar nga Yuka Books. Gjatë vizitës, ambasadorja zhvilloi takime me rektorin Prof. Dr. Blerim Olluri dhe prorektorin për marrëdhënie ndërkombëtare, Prof. Asoc. Dr. Venera Lljunji, me të cilët diskutoi për mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve arsimore të Kosovës dhe Izraelit përmes projekteve akademike dhe shkëmbimeve të stafit e studentëve. Gjatë promovimit ishin të pranishme edhe redaktorja Netta Gurevitch dhe ilustratorja Danielle Peleg, të cilat diskutuan vlerat edukative dhe kulturore të librit që përshkruan ngjarjet tragjike të 7 tetorit 2023 në Izrael.



Rektori dhe Prorektorja e Kolegjit AAB zhvilluan një takim në Ambasadën e Japonisë

Rektori i Kolegjit AAB, Blerim Olluri, dhe Prorektorja për Marrëdhënie Ndërkombëtare, Venera Lljunji, zhvilluan një takim në Ambasadën e Japonisë me z. Yamanaka, i cili po përmbyll mandatin si i Ngarkuar me Punë, dhe z. Tanigaki, pasardhësin e tij në këtë detyrë. Gjatë takimit u diskutua për bashkëpunimin dy palësh, përfshirë marrëveshjet me dy universitete japoneze dhe promovimin e kulturës japoneze përmes hapësirës së dedikuar në ambientet e Kolegjit.



Kolegji AAB në pritjen zyrtare për Profesorin e njohur japonez, Hisashi Owada

Me ftesë të Ambasadorit të Japonisë, Sh.T. Z. Kiminori Iwama, në Prishtinë u organizua një pritje zyrtare në nder të Prof. Hisashi Owada, jurist i njohur dhe ish-gjyqtar në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. Në këtë ngjarje morën pjesë përfaqësues të lartë të botës akademike dhe diplomatike, përfshirë Rektorin e Kolegjit AAB, Prof. Dr. Blerim Olluri, dhe Prorektorin Venera Lljunji. Rektori Olluri pati rastin ta prezantojë misionin dhe vizionin e AAB-së para Prof. Owada-s, duke theksuar përkushtimin ndaj cilësisë akademike dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.



SHKËMBIME TË STAFIT AKADEMIK PËRMES ERASMUS+

Profesorët e Kolegjit AAB ligjërues të ftuar nga Universiteti Kehl në Gjermani

Në kuadër të programit “Guest Lecturers”, profesorët e Kolegjit AAB, Bashkim Rrahmani dhe Basri Muja, qëndruan në Kehl University në Gjermani, ku zhvilluan ligjërata dhe takime akademike. Ata ligjëruan për studentët e nivelit master në fushën e Administratës Publike, duke ndarë përvoja dhe perspektiva nga praktika akademike kosovare. Vizita përfshiu edhe takime me përfaqësues të Zyrës për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe të Zyrës së Cilësisë dhe Zhvillimit Akademik. U diskutuan mundësitë për bashkëpunim institucional, shkëmbime akademike dhe avancimin e kërkimit shkencor ndërmjet dy institucioneve. Pjesë e rëndësishme e vizitës ishte edhe thellimi i dialogut mbi standardet e arsimit të lartë dhe ndërtimi i platformave të përbashkëta për zhvillim të mëtejshëm.



Profesoresha Gresa Shaqiri përfaqëson Kolegjin AAB në Javën Ndërkombëtare të Stafit në Poloni

Në Universitetin e Lodz-it në Poloni u mbajt Java Ndërkombëtare e Stafit, ku Kolegjin AAB e përfaqësoi profesoresha Gresa Shaqiri nga Fakulteti i Administratës Publike. Në aktivitet morën pjesë përfaqësues nga 16 vende, duke trajtuar tema si ribrendimi i universiteteve, përdorimi i inteligjencës artificiale në arsimin e lartë dhe strategjitë e ndërkombëtarizimit. Shaqiri e vlerësoi pjesëmarrjen si kontribut të çmuar për avancimin ndërkombëtar të AAB-së.



Dy zyrtaret e Universitetit Lodz në Poloni qëndrojnë për vizita dhe takime në AAB

Në kuadër të shkëmbimit të stafit, Agoda Białota dhe Patrycja Gorzkiewicz nga Universiteti Lodz në Poloni qëndruan në Kolegjin AAB, ku zhvilluan takime me rektorin Blerim Olluri, prorektorin Venera Lljuni, drejtoreshën Ilirjana Geci dhe pjesëtarë të stafit akademik. Gjatë vizitës, ato prezantuan Universitetin Lodz dhe programet që ofron, duke theksuar mundësitë e bashkëpunimit ndëruniversitar. Një takim i veçantë u mbajt me Unionin Studentor të AAB-së, ku u diskutua për përfaqësimin e studentëve, planet për të ardhmen dhe angazhimin në projekte ndërkombëtare. Kjo vizitë kontribuoi në forcimin e lidhjeve akademike dhe kulturore mes dy institucioneve.



Prof. Ramón Sanguino Galván dhe Prof. Ascensión Barroso vizitojnë AAB College në kuadër të shkëmbimit të stafit akademik

Kolegji AAB mirëpriti Prof. Ramón Sanguino Galván dhe Prof. Ascensión Barroso nga Universiteti Extremadura në Spanjë, në kuadër të programit Erasmus+ për shkëmbimin e stafit akademik. Gjatë vizitës, ata zhvilluan takime me rektorin Blerim Olluri, prorektorin Venera Lljuni dhe dekanët e fakulteteve, duke diskutuar mundësi bashkëpunimi në shkëmbimin e studentëve dhe stafit, projektet kërkimore dhe organizimin e konferencave ndërkombëtare. Profesorët prezantuan Universitetin Extremadura dhe morën pjesë në lansimin e projektit HUMLIT, financuar nga Bashkimi Evropian. Kjo vizitë shënon një hap të rëndësishëm në forcimin e partneritetit ndërkombëtar dhe zgjerimin e mundësive për komunitetin akademik të dy institucioneve.



Grupi Tematik i EUA-së mblidhet në Nisë për të avancuar zhvillimin transnacional të stafit në arsimin e lartë



Takimi i parë i Grupit Tematik për mësimdhënie dhe mësimnxënie të EUA-së u mbajt me 5-6 qershor 2025 në Universitet Côte d'Azur, në Nisë, me fokus te "Zhvillimi i Stafit dhe Bashkëpunimi Transnacional". Ky grup funksionon në kuadër të projektit STAFF-DEV, i financuar nga Erasmus+, dhe synon zhvillimin profesional ndërkombëtar të stafit akademik. Në takim morën pjesë përfaqësues nga universitete të njohura evropiane, ndërsa Kolegji AAB u përfaqësua nga prorektorja Venera Lljunji dhe Ereza Mehmeti, të cilat kontribuan aktivisht me ide dhe qasje praktike. Ato u vlerësuan si ndër kontribueset më të dalluara të takimit.



AAB kontribuon në seminarin për integritetin akademik, të organizuar nga MASHTI dhe BE

Kolegji AAB mori pjesë në seminarin "Integriteti Akademik: Sfidat dhe Zgjidhjet në Arsimin e Lartë", të organizuar nga MASHTI dhe mbështetur nga BE përmes programit TAM. Në këtë ngjarje morën pjesë përfaqësues të institucioneve nga Kosova dhe Evropa, ku u diskutuan sfidat dhe praktiket për ruajtjen e integritetit akademik. Prorektorët Venera Lljunji dhe Furtuna Mehmeti, si dhe prof. Mimoza Kamberi nga AAB, kontribuan me diskutime dhe ide konkrete për ndërtimin e një kulture të përgjegjshme akademike. U prezantuan gjithashtu zgjidhje teknologjike si platforma INSPIRA.



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE TË ARSIMIT TË LARTË


Kolegji AAB nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin “Kadri Zeka” Gjilan

Kolegji AAB dhe Universiteti “Kadri Zeka” në Gjilan kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, përfaqësuar nga Pr orektorja Venera Lljunji dhe Rektori Artan Dermaku. Qëllimi i marrëveshjes është forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional përmes projekteve të përbashkëta akademike e kërkimore, shkëmbimit të stafit dhe studentëve, si dhe organizimit të aktiviteteve si konferenca, punëtori dhe seminare me interes të ndërsjellë. Kjo marrëveshje shënon një hap të rëndësishëm drejt zhvillimit të mëtejshëm të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor ndërmjet dy institucioneve.



Fakulteti i Komunikimit Masiv nënshkruan memorandum bashkëpunimi

Fakulteti i Komunikimit Masiv në AAB nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Fakultetin e Komunikimit dhe Medias nga Universiteti Cyril Methodius në Sllovaki. Marrëveshja përfshin shkëmbimin e studentëve dhe stafit, projekte të përbashkëta akademike dhe shkëmbim kulturor. Fakulteti po zhvillon projektin “Shkëmbime Virtuale Evropiane” për të forcuar aftësitë dhe dialogun ndërkulturor mes të rinjve nga Sllovakia, Spanja dhe Ballkani Perëndimor.



THIRRJET E HAPURA PËR SHKËMBIM ERASMUS+

Šiaulių Valstybinė Kolegija në Lituani hap thirrje për shkëmbim studentor

Thirrje për aplikim për shkëmbim studentor Erasmus+ në Šiaulių Valstybinė Kolegija në Lituani, për semestrin e vjeshtës 2025–2026. Aplikimi është i hapur për 2 studentë nga drejtimet biznes, menaxhim dhe shkenca mjekësore. Kandidatët duhet të jenë të regjistruar nga semestri i 2-të deri në të 5-in, të kenë nivel B2 në anglisht dhe mesatare mbi 8.5. Bëhet financimi për 5 muaj me bursë. Lëndët për shkëmbim janë të publikuara dhe nuk ndryshohen. Afati për aplikim është 31 maj 2025.



Bursa Erasmus+ për Studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike

Thirrje për aplikim – Bursa Erasmus+ për studentët e Shkencave Kompjuterike. Studentët e këtij fakulteti mund të aplikojnë për bursë për semestrin e ardhshëm.

Dokumentet: pasaportë, transkripta, certifikatë gjuhe (B1+), fotografi pasaporte. Vetëm aplikimet e plota shqyrtohen; kandidatët e përzgjedhur ftohen në intervistë. Afati për aplikim është 05 qershor 2025.



“Aurel Vlaicu” University of Arad në Romania hap thirrje për javën ndërkombëtare të stafit



Thirrje për aplikim. Në kuadër të projektit ERASMUS+ KA171, Kolegji AAB shpalli thirrjen për pjesëmarrje në Javën Ndërkombëtare të Stafit që do të mbahet nga data 7 deri më 11 korrik 2025 në Universitetin Arad në Rumani. Janë përzgjedhur katër (4) përfaqësues akademikë për të marrë pjesë në këtë mobilitet ndërkombëtar që synon shkëmbimin e përvojave akademike, ndërtimin e bashkëpunimeve të reja dhe promovimin e ndërkombëtarizimit.



Kontakti

Adresa:

Rr. Elez Berisha, Nr.56
10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

Kontakti i përgjithshëm:

info@aab-edu.net

Zyra Ndërkombëtare dhe e Projekteve:

Emri dhe Mbiemri	Pozita	Email
Venera Llunji	Pro-rektore Zyra për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Bashkëpunim	venera.llunji@aab-edu.net
Ilirjana Geci	Drejtoreshë në Zyrën për Zhvillim të Projekteve	ilirjana.geci@aab-edu.net
Mimoza Kamberi	Koordinatorë për bashkëpunim dhe shkencë	mimoza.kamberi@aab-edu.net
Erëza Mehmeti	Koordinatorë për zhvillim të projekteve	ereza.mehmeti@aab-edu.net
Jehona Rukovci	Koordinatorë për zhvillim të karrierës	jehona.rukovci@aab-edu.net